

Ligji 108/2017 date 30.11.2017

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 61/2012 “PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Kreu IX/1 “Pijet energjike” dhe nenet 77/1 dhe 77/2 shfuqizohen.

Neni 2

Në nenin 78, pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Nikotinë lëng, që klasifikohet në kodet 3824 99 56 dhe 3824 99 57 të Nomenklaturës së Kombinar të Mallrave, që përdoret për mbushjen e cigareve elektronike të klasifikuara në kodet e 8543 70 90 të Nomenklaturës së Kombinar të Mallrave dhe për krijimin e një procesi tymosjeje.”.

Neni 3

Pas nenit 80 shtohet neni 80/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 80/1

Importimi dhe prodhimi i letrës së cigareve në formën e broshurave apo të tubave që përfshihen në kodin 4813 1000 të Nomenklaturës së Kombinar të Mallrave, kryhet përkundrejt marrjes së një autorizimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave nxjerr udhëzim për zbatim të këtij neni, lidhur me përcaktimin e kushteve, kriterëve dhe afatin e autorizimit, si dhe procedurën e monitorimit të importeve dhe prodhimit të letrës së cigareve në formën e broshurave apo të tubave të letrës kundrejt sasisë së duhanit të importuar apo të blerë brenda vendit, në baza vjetore.”.

Neni 4

Shtojca nr. 1, “Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë”, zëvendësohet me shtojcën nr. 1 bashkëlidhur dhe bëhet pjesë përbërëse e ligjit.

Neni 5

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2018.

K R Y E T A R I
Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 30.11.2017

Shpallur me dekretin nr. 10689, datë 15.12.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta

Botuar ne F.Zyrtare 222/2017

Dale nga shtypi me 19.12.2017